

Letërnjoftimi i Komunës së

**FERIZAJIT**

**2014**

Maj, 2015





## Fakte


- Të hyrat buxhetore të komunës së Ferizajit më 2014 kanë shënuar rritje në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2014 të hyrat kanë qenë 1,5 milion më shumë se në vitin 2013.
- Të hyrat më të mëdha gjatë vitit 2014 kanë qenë nga tatimi në pronë 1,6 milion euro.
- Nga buxheti i Komunës së Ferizajit për vitin 2014 janë shpenzuar 50% në paga dhe meditare, ndërsa 36% në investime kapitale.
- Në administratë komunale janë të punësuar 2,488 persona, apo një shërbyes civil për 395 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Ferizaji nuk ka të punësuar me kontratë mbi vepër.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,860 persona, prej tyre 1,537 mësimdhënës. Në Komunën e Ferizajit raporti nxënës/mësimdhënës është 36,5. Mesatarja në shkallë vendi është 29,9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 345 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Ferizajit është 324,25. Mesatarja në shkallë vendi është 282,7.
- Ferizaji gjatë vitit 2014 ka pasur 361 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Ferizaj rreth 0,27% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Ferizajit në vitin 2014 janë regjistruar 722 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë janë shuar 94 biznese.
- Kryetari i Ferizajit z.Muharrem Sfarqa gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 17 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 25%, apo mbi mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

## 2 Qeverisja komunale

Komuna e Ferizajit në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka kaluar nga qeverisja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Kryetari aktual i Ferizajit z.Muharrem Sfarqa (LDK) ka fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes tij dhe ish Kryetarit nga radhët e PDK-së z.Agim Aliu.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 48,111 apo rreth 48,5% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur me 1 dhjetor 2013, Muharrem Sfarqa ka marr 50,85%, ndërsa Agim Aliu ka marr 49,15% të votave.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: LDK 14 ulëse, PDK 13 ulëse, AAK-LDD pesë ulëse, VV me katër, AKR tre ulëse, ndërsa Nisma Qytetare e Ferizajit, PDAK dhe PD me nga një ulëse. Pas zgjedhjeve LDK-ja ka bërë koalicion me AAK-në dhe NQF-në.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Ferizajit në bazë të zgjedhjeve 2013



### 3 Buxheti i Komunës së Ferizajit


Më 2014, Komuna e Ferizajit kishte buxhet prej 24,9 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh më shumë krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe medijtje 11 milion për shëndetësin, arsim, administratë etj. Buxheti për investime kapitale është 9 milion euro, një rritje për 2 milion më shumë në krahasim me dy vitet paraprake.

**Grafikoni nr. 3** Buxheti total i Komunës së Ferizajit dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Ferizajit ishin afro 3,7 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje për afro 1 milion euro në krahasim me vitin 2013.

**Grafikoni nr.4** Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Ferizajit 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë 1,7 milion euro. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 45,7% të të hyrave të përgjithshme, si e hyrë e dytë janë nga pagesat nga regjistrimi i automjeteve që përbëjnë 18% të të hyrave të përgjithshme.

**Grafikoni nr.5** Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Ferizajit ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Peja, Gjiilan, Gjakovë, Mitrovica, etj., ndërsa më pak se sa Prishtina dhe Prizreni.

**Grafikoni nr.6** Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për telefona mobil, telefona fikse, riparimi i veturave, kanë shënuar rritje, Në veçanti riparimi i veturave, duke e krahasuar me një vitë më heret në 2014 janë shpenzuar 20 mij euro më shumë për këtë kategori, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.


**Grafikoni nr. 7** Shpenzimet për disa kategori buxhetore



## 4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Ferizaji e ka përmbyllur me 2,488 të punësuar në sektorin publik, 175 punonjës më shumë se sa një vit më parë. Përgjatë këtij viti, janë punësuar 19 shërbyes civil më shumë në kuadër të administratës dhe 142 punonjës në sektorin e arsimit dhe 14 në sektorin e shëndetësisë.

**Grafikoni nr.9** Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Ferizajit




Ferizaji ka të punësuar një shërbyes civil për 395 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori



Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,860 persona, prej tyre 1,537 mësimdhënës. Në Komunën e Ferizajit raporti nxënës/mësimdhënës është 36,5. Mesatarja në shkallë vendi është 29,9. Edhe përkunder faktit që në vitin 2014 janë punësuar 142 punonjës në sektorin e arsimit raporti nxënës/mësimdhënës mbetet i lartë.


Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Ferizajit





Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 345 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Ferizajit është 324,2. Mesatarja në shkallë vendi është 282,7.


**Grafikoni nr.13** Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale

Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 722 biznese të reja, një numër i përafërt me bizneset e regjistruara në dy vitet paraprake. Prej 722 bizneseve të regjistruara më 2014, 307 janë biznese me fushë veprimtari tregtare, 89 industri përpunuese, 64 biznese të ndërtimit, 62 hoteleri/restorante etj


**Grafikoni nr.14** Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 94 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

**Grafikoni nr.15** Llojet e bizneseve të shuara më 2014



Instituti GAP

## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Muharrem Sfarqa gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 17 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z.Svarqa ka arritur të realizoj 23% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

**Grafikoni nr.16** Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)

